

VENDIM
Nr.329, datë 30.6.1993

PËR KRIJIMIN E INSPEKTORARTIT RAJONAL TË NDIHMËS DHE PËRKUJDESJES
SHOQËRORE

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohet Inspektorati Rajonal i Ndihmës dhe i Përkujdesjes Shoqërore në Ministrinë e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale me degë në prefektura.
2. Inspektorati Rajonal i Ndihmës dhe i Përkujdesjes Shoqërore ka këto detyra kryesore:
 - Të inspektojë seksionet e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në disa rrethe, bashki e komuna.
 - Të kontrollojë përdorimin e bllokndihmës sipas destinacionit.
 - Të kontrollojë gjithë dokumentacionin që lidhet me:
 - a) pretendimin për ndihma;
 - b) dhënien e ndihmës;
 - c) marrjen e vendimeve nga këshillat e bashkive dhe komunave;
 - ç) ankimin e pretenduesve për ndihmë.
 - Të organizojë seminare për kualifikimin e punonjësve të seksioneve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror.
3. Në organikën e personelit të administratës shtetërore të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror shtohen 45 punonjës. Pagat e inspektorëve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror njësohen në pagat e punonjësve të administratës shtetërore të punës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi